

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7804  
E mërkurë, 5 qershor 2024  
Çmimi 0.50

Në prag të zgjedhjeve,  
BE-ja thotë se Rusia po  
përhap dezinformata



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
 [facebook.com](#)  
Gazeta "Epoka e re"



RADOIÇIQI 'PËRPLAS' KURTIN DHE HARADINAJN

## HARADINAJ, KURTIT: PËRGJIGJU NË PYETJET E VJETRA. ÇKA BËRË I MBULUAR ME BATANIJE NË MAKINË ME AGJENTËT SERBË MË 2004 NË KLINË?

FAQE 4-5



Përgjimet e reja që janë publikuar, ku dëgjohet shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, duke biseduar me kriminelin serb Milan Radoiqiq, përgjegjësin kryesor të sulmit në Banjskë, kanë përplasur në distancë

kryeministrin Albin Kurti dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Kurti ka theksuar të martën se nuk e ka dëgjuar bisedën në mes të Kusarit dhe Radoiqiqit por, sipas tij, qytetarët e dinë se kush ka bashkëpunuar me Radoiqiqin, duke

aluduar në pritjen që i kishte bërë Haradinaj si kryeministër Radoiqiqit. E Haradinaj ka kërkuar nga Kurti të përgjigjet në pyetjet e vjetra se si u gjet i mbuluar me batanje në makinë me agjentët serbë në vitin 2004 në Klinë

BYTYCI NË SPECIALE: NUK DUA QË LIBRI IM TË PËRDORET SI DËSHMI PËR T'I AKUZUAR LUFTETARËT E LIRISË F. 4



PRISHJA E RAPORTEVE, KURTI: ME PRESIDENTEN OSMANI NDONJËHERË KEMI EDHE DALLIME F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@m.t.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

SHIFRA REKORDE TË TURIZMIT NË ITALI MË 2023 F. 2

MELONI DO T'I VIZITOJË DY QENDRAT E MIGRANTËV NË SHQIPËRI F. 2

QYTETET E MËDHA TË KOSOVËS PO I NDIEJNË EFEKTET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE F. 7

## EKONOMI



RRITEN TË HYRAT E QEVERISË NË TREMUJORIN E PARË KRAHASUAR ME VITIN E KALUAR F. 8

FORUMI EKONOMIK KOSOVË - TURQI UNDOQ NGA 200 BIZNESE, POTENCIAL I FORTË I BASHKËPUNIMIT F. 8

## SPORT



SHËNOHET DITËN BOTËRORE E SPORTIT DHE AMBIENTIT NË KOSOVË F. 10

## Meloni do t'i vizitojë dy qendrat e migrantëve në Shqipëri



**TIRANË, 4 QERSHOR** - Kryeministria e Italisë, Georgia Meloni, do të qëndrojë të mërkurën në Shqipëri. Ajo do t'i vizitojë qendrat e migrantëve që do të drejtohen nga vendi i saj.

Me një marrëveshje me Romën, të nënshkruar në nënitor të vitit të kaluar, Tirana ra dakord t'i pranojë azilkërkuesit e kapur në Detin Mesdhe dhe t'i strehojë ata derisa kërkesat e tyre të përpunohen.

Italia, ndërkohë, do ta financojë ngritjen e qendrave të pritjes - njëra në Shëngjin, tjetra në Gjadër - si dhe do t'i paguajë shpenzimet për sigurinë dhe kujdesin

mjkësor.

Në Shengjin ndërtimi i qendrës është afër përfundimit, ndërsa në Gjadër ende jo.

Qendrat do të mund të strehojnë maksimum 3 000 azilkërkues brenda një periudhe.

Marrëveshja është për pesë vjet dhe me të drejtë rinojimi edhe për pesë vjet të tjera. Se kur do të nisë zbatimi i saj, nuk është ende e qartë.

Sipas autoriteteve të tē dyja vendave, marrëveshja ka tri objektiva: të luftojë trafikimin e paligjshëm të njerëzve, të parandalojë flukset e parregullta

dhe të mirëpresë ata që kanë vërtet të drejtë e mbrojtjes.

Në Shqipëri, opozita e kundërshtoi marrëveshjen, duke thënë se kishte mungesë transparencë. "Ky lajm vjen si surprizë në Shqipëri, pasi nuk kishte asnjë debat politik apo publik për një çështje kaq sensitive për qytetarët dhe përmbarë vendin", tha Partia Demokratike pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Meloni dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pas vizitave në Shëngjin dhe Gjadër, do të zhvillojnë një konferencë përgazetarët.

## Nisin hetimet për 16 policë të Rinasit, dyshohen për kalime ilegale të kufirit

**TIRANË, 4 QERSHOR** - Gjashtëmbëdhjetë punonjës të polisës kufitare në Aeroportin e Rinasit në Shqipëri dyshohet se janë përfshirë në një skemë korrupzioni për kalimin e personave drejt vendeve të Bashkimit Evropian, në mënyrë të paligjshme. Për tetë prej tyre tashmë është caktuar masë sigurie, ndërsa tetë të tjera po hetohen në gjendje të lirë. Sipas një njoftimi nga Prokuroria e Tiranës, punonjësit e polisë dyshohet se, në bashkëpunim me pronarin e një agjencie udhëtimesh, kanë siguruar

mundësi për kalimin e qytetarëve të dëbuar shqiptarë nga vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian. Gjykata ka vendosur masën e sigurisë "arrest me burg" për njërin prej punonjësve të polisës kufitare; "arrest shtëpie" për tre të tjera dhe "detyrim për t'u paraqitur në polici" për katër të tjera. Dyshimet që bien mbi ta kanë të bëjnë me "shpërdorim detyre" dhe "korruption pasiv". Pronari i agjencisë që ka bashkëpunuar, u ndalua pak ditë më parë, pasi u kap me lëndë narkotike.


Hetimet e vazhdueshme, pastaj, zbuluan skemën e grupit në fjalë. Sipas Prokurorisë në Tiranë, së paku 200 shtetas janë lejuar të kalojnë paligjshëm nga Aeroporti i Rinasit "Nënë Tereza" drejt vendeve të BE-së.

Në një rast rezulton se është lejuar edhe kalimi i një të mituri pa prokurën e prindit.

Grupi që mundëson kalimin, thuhet se përfitonte një shumë prej 500 eurosh nga secili. Kjo veprimtari e paligjshme, sipas Prokurorisë në Tiranë, zgjati rrith një vit - nga muaji mars i vitit 2023 deri në mars të këtij viti.



## Shifra rekorde të turizmit në Itali më 2023



**ROMË, 4 QERSHOR** - Italia e ka regjistruar numrin më të madh të turistëve ndonjëherë më 2023, sipas të dhënavë të fundit prej Zyrës shtetërore të Statistikave, Istat dhe Ministrisë së Turizmit. Vitin e kaluar Italia ka regjistruar më shumë se 134 milionë turistë dhe rrith 451 milionë akomodime, sipas autoriteteve italiane.

Istat ka thënë se shifrat e vitit të kaluar kanë qenë rekorde, dhe në krahasim me vitin 2022, numri i vizitorëve është rritur për 13.4 për

qind - që do të thotë rrith 16 milionë më shumë pushues.

Shifrat i tejkalojnë edhe ato të vitit 2019, një vit para shpërrimit të pandemisë së koronavirusit, kur janë regjistruar 131 milionë pushues.

Italia është një prej destinacioneve më të popullarizuara për turistët dhe më shumë se gjysma e tyre janë të huaj. Pjesën tjetër e përbëjnë italaniët që bëjnë turizëm të brendshëm. Rajonet me më së shumti vizitorë

janë Veneto, zona e Venecias, Toskana, Lombardia dhe Lazio, pa përjashtuar edhe kryeqytetin, Romën.

Megjithatë, këto shifra nuk janë lajm i mirë për të gjithë italaniët. Venecia, Roma dhe disa qytete të Toskanës janë të stërvngarkuara gjatë sezonit të pushimeve. Prandaj, banorët e këtyre zonave bëjnë se cilëën herë e më shumë thirrje që numri i turistëve të kontrollohet ose kufizohet.

Venecia, shembull, ka vendosur taksë për turistët.

## Ushtria australiane do të pranojë edhe rekrutë të huaj

**CANBERRA, 4 QERSHOR** - Forca e Mbrotjtes e Australisë (ADF) do të lejojë edhe rekrutë nga vendet e huaja në radhët e veta, bëri të ditur Ministria e Mbrotjtes e këtij vendi. Australia, prej vitesh, përballet me regjistrime të ulëta të ushtarëve. Kjo, sipas zyrtarëve, është pasojë e nivitet të ulët të papunësisë. Shifrat e fundit të Qeverisë vlerësojnë se Forca e Mbrotjtes ka mungesë të rrith 4.400 trupave.

Nga korriku, shtetasit e Zelandës së Re që janë banorë të pérhershëm të Australisë, mund të aplikojnë për t'iu bashkuan ushtrisë australiane, ndërsa nga viti i ardhshëm këtë do të mund ta bëjnë edhe banorët nga Britania e Madhe dhe vende të tjera, përfshirë ShBA-në dhe Kanadanë. Ministri australian i Mbrotjtes, Richard Marles, tha se këto ndryshime "janë thelbësore

përballë sfidave të sigurisë, gjatë dekadës së ardhshme dhe më tej". Kanbera ka shprehur vazhdimisht shqetësimë për, siç është shprehur, veprimet armiqësore të Kinës.

Nën aleancën e njohur si "Pesë sy", Australia, Britania, ShBA-ja, Kanadaja dhe Zelanda e Re punojnë së bashku edhe në shkëmbimin e informacioneve të inteligjencës.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

VAZHDON PROCESI GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së NË HAGË

# Bytyçi në Speciale: Nuk dua që libri im të përdoret si dëshmi për t'i akuzuar luftëtarët e lirisë

Gazetari i luftës, Nuhi Bytyçi, ka kërkuar nga Gjykata Speciale dhe ZPS-ja që mos ta përdorin librin e tij "Libri i luftës" si dëshmi për t'i akuzuar luftëtarët e lirisë. Gjatë dëshmisi së tij në Hagë, Bytyçi ka thënë se gjatë kohës së luftës gjithmonë ka funksionuar e punuar si gazetar i pavarur dhe vullnetar dhe se këtë gjë, sipas tij, e kishte bërë për arsyen që shumë kohë të gjatë, edhe para luftës, Kosova ishte në terr informativ. Bytyçi ka thënë se UÇK-ja nuk ka pasur hierarki strikte siç e kanë ushtritë e rregullta. Ai ka thënë se në disa zona ka pasur vështirësi për të xhiruar edhe pse ishte në praninë e Hashim Thaçit

**HAGË, 4 QERSHOR** - Gazetari i luftës, Nuhi Bytyçi, ka nisur dëshminë në Gjykatën Speciale në Hagë në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi. Bytyçi është dëshmitari i 71-të në gjykimin ndaj kërreve të UÇK-së në Hagë, i cili ka nisur në prill të vitit 2023. Gjatë dëshmisi së tij në Hagë, dëshmitari Bytyçi ka thënë se nuk dëshiron që Specialja, sidomos Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), ta konsiderojë librin e tij si dëshmi për t'i akuzuar liderët e UÇK-së.

"Nuk dua që kjo gjykatë, sidomos prokuroria, këtë libër timin ta konsiderojë si një dëshmi për t'i akuzuar luftëtarët e lirisë", ka thënë dëshmitari derisa po pyetej nga prokurori Matt Halling për librin e tij "Libri i luftës".

Dëshmitari ka thënë se gjatë kohës së luftës gjithmonë ka funksionuar e punuar si gazetar i pavarur dhe vullnetar dhe se këtë gjë, sipas tij, e kishte bërë për arsyen që shumë kohë të gjatë, edhe para luftës, Kosova ishte në terr informativ, raporton "Betimi për Drejtësi".

I pyetur se si ka pasur mundësi që të mbajë shënimë për të gjitha ato data të cilat përmenden në libër, dëshmitari ka thënë se e ka pasur të vështirë një gjë të tillë pasi që ka qenë gazetar vullnetar dhe jo i akredituar zyrtarisht.

"Fillimisht, të them të drejtën, në ato rrethana të luftës, si gazetar vullnetar, ashtu si ka qenë edhe Ushtria e Kosovës - ushtri vullnetare - e mbështetur nga tërë populli shqiptar, kam pasur shumë vështirësi në punën time. Fillimisht, nuk kam pasur akreditim zyrtar nga Serbia për shkak se edhe unë personalisht nuk e kam njobur shtetin e Serbisë se ka qenë shtet okupues", ka thënë dëshmitari Bytyçi.

Gjithashtu, Bytyçi ka thënë se edhe në vitin 2019, përkatësisht në vitin kur e kishte botuar librin, kishte deklaruar se datat apo emrat mund të mos jenë të saktë aty ngaqë, sipas tij, nuk ka mundur të mbajë ndonjë ditar të përpiktë ashtu siç mund të mbajnë gazetarët në rrethana normale.

"Kam punuar në rrethana të jashtëzakonshme nëpër punkte policore dhe nuk kam pasur mundësi në asnjë mënyrë të mbaj ditar në mënyrë të rregullt, t'i shënoj datat, t'i shënoj emrat



me të cilët kam kontaktuar, me të cilët kam intervistuar. Kështu, edhe në deklaratën time më 30-31 korrik 2019 kam deklaruar se disa data dhe disa emra që janë në libër mund të mos jenë të saktë, se mund të mungojë ndonjë emr... për arsyen se nuk kam mundur të mbaj ditar të përpiktë ashtu siç mund të mbajnë gazetarët në rrethana normale", ka thënë dëshmitari.

Më tutje, Bytyçi ka thënë se nuk ka ndodhur asnjëherë të punojë me direktiva të dikujt tjetër. "Nuk ka ndodhur që të punoj sipas diktatit të dikujt. Edhe në kohën kur kam punuar gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës kam qenë kundër cezurës dhe në asnjë mënyrë nuk kam lejuar as pas luftës as gjatë luftës që dikush të diktojë në punën time", ka thënë ai.

Ish-gazetari i RTP-së dhe RTK-së ka thënë se librin e tij para botimit nuk e ka pasur askush tjetër përvëç profesionistëve, të cilët janë angazhuar në redaktimin e tij. "Para botimit, librin tim e kanë parë vetëm redaktorët dhe recensenti i librit. Kuptohet edhe lektorja e librit, kurse as nga Shtabi i

Përgjithshëm dhe asnjë qytetar tjetër i Republikës së Kosovës të përgatitur për botim nuk e kanë pasur", ka thënë ai.

Ndërsa pas botimit ai ka thënë se një kopje të librit ia ka dhënë ish-presidentit Hashim Thaçit dhe një Fatmir Limajt. "Pas botimit, presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ia kam dhuruar librin, të tjerëve s'e di. Zotëri Krasniqi nuk e di a ia kam dhënë a jo. E di që zotëri Selimit dhe zotëri Veselit nuk ua kam dhuruar. Po edhe Fatmir Limaj e pati kërkuar, ia kam dhuruar në zyrën e tij sa ka qenë zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës", ka thënë dëshmitari, duke shtuar se nuk ka marrë komente nga ta.

Ndërsa prokurori Halling i ka thënë dëshmitarit se më herët në dëshminë e tij kishte thënë që asnjë kopje të librit nuk ia kishte dhënë asnjërit prej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe se tashmë një gjë të tillë po e dëshmon ndryshe. Megjithatë, dëshmitari ka thënë se asnjë kopje të librit nuk e ka dorëzuar para botimit.

Gjatë dëshmisi së tij, dëshmitari ka thënë se lufta e UÇK-së ka

genë luftë për liri. "Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për liri. Ishte luftë kundër pushtimit serb. Ishte luftë kundër dhunës dhe terroristit në mbarë Kosovën dhe që mjetet paqësore ishin shterur dhe kjo ishte luftë e imponuar së cilës iu bashkëgjiten të gjithë shqiptarët nga Kosova dhe vendet e tjera. Ishte një luftë vullnetare se Kosova nuk ishte shtet dhe nuk e kishte ushtrinë e rregullt siç i kanë shtetet e tjera në rrethana normale", ka thënë Bytyçi.

## "UÇK-ja nuk ka pasur hierarki strikte"

Ish-gazetari i Radio Televizionit të Prishtinës (RTP) dhe Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), Nuhi Bytyçi, ka thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) nuk ka pasur hierarki strikte siç e kanë ushtritë e rregullta. Ai ka thënë se në disa zona ka pasur vështirësi për të xhiruar edhe pse ishte në praninë e Hashim Thaçit. "Nuk kanë pasur ndonjë hierarki strikte siç kanë ushtritë e rregullta sepse unë kam pasur vështirësi në disa

zona të luftës, sidomos në Dukagjin. Kam shkuar bashkë me z. Thaçit, i cili ka qenë përgjegjës për informim, por ushtarët që kanë qenë në komandën e z. Ramush Haradinaj nuk kanë lejuar të bëjmë filmime bashkë me kameramanin tim Abaz Zekën. Po ashtu, edhe në Zatriq të Rahovecit kam shkuar të xhiroj dhe komandanti lokal, Idriz Vehapi, edhe pse ka qenë i pranishëm z. Hashim Thaçi, nuk më ka lejuar të xhiroj. Kjo dëshmon se vërtet nuk ka pasur ndonjë hierarki strikte në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë dëshmitari.

Përpara kësaj, dëshmitari ka thënë se ai kishte shkuar për të raportuar dhe se nuk i kanë interesuar organizimi dhe struktura e UÇK-së, por më pas ka theksuar se kishte vërejtur që hierarki nuk ekzistonte aty. "Nuk më kanë interesuar as organizimi as struktura e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kam bashkëpunuar me njerëzit kompetentë që kanë qenë në atë periudhë për komunikim me gazetarët siç ka qenë z. Hashim Thaçi - përgjegjës për informim dhe zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi. Me këtë dy persona kam bashkëpunuar në mënyrë intensive në zonat e luftës, kurse në Prishtinë kam bashkëpunuar ngushtë me përfaqësuesin e përgjithshëm politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Adem Demaci", ka thënë dëshmitari Bytyçi.

Prokurori Halling është fokusuar te një takim që dëshmitari kishte pasur me Rexhep Selimi gjatë kohës së luftës në të cilin ai e kishte pasqyruar në libër që ka marrë kritika nga tashmë i akuzuar për mënyrën e raportimit gjatë asaj periudhe.

"Kam pasur me z. Rexhep Selimi dhe kishte shumë të drejtë që thoshte jo vetëm anëtarët e UÇK-së, por edhe i gjithë populli nuk ishte i kënaqur me informimin që bëhej në atë kohë në Radiotelevizionin Shqiptar, por edhe në disa medie të tjera shqiptare për situatën në zonën e luftës. Thuhej se mbrohej pragu i shtëpisë dhe ishte vërejtje me vend, se Ushtria e Kosovës po luftonte për çlirimin e vendit dhe jo vetëm për mbrojtje të pragut të shtëpisë", ka thënë dëshmitari, duke shtuar se ky takim ishte mbajtur në prill ose fillim maj të 1998-s.



RADOIÇIQI 'PËRPLAS' KURTIN DHE HARADINAJN

## Haradinaj, Kurtit: Përgjigju në pyetjet e vjetra. Çka bërë i mbuluar me batanije në makinë me agjentët serbë më 2004 në Klinë?

Përgjimet e reja që janë publikuar, ku dëgjohet shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, duke biseduar me kriminelin serb Milan Radoiqiq, përgjegjësin kryesor të sulmit në Banjskë, kanë përplasur në distancë kryeministrin Albin Kurti dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Kurti ka theksuar të martën se nuk e ka dëgjuar bisedën në mes të Kusarit dhe Radoiqiqit por, sipas tij, qytetarët e dinë se kush ka bashkëpunuar me Radoiqiqin, duke aluduar në pritjen që i kishte bërë Haradinaj si kryeministër Radoiqiqit. E Haradinaj ka kërkuar nga Kurti të përgjigjet në pyetjet e vjetra se si u gjet i mbuluar me batanije në makinë me agjentët serbë në vitin 2004 në Klinë

**EPOKA  
ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur për përgjimet e reja që janë publikuar ku dëgjohet shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, duke biseduar me kriminelin serb Milan Radoiqiq, përgjegjësin kryesor të sulmit në Banjskë.

Kurti ka thënë se për këtë rast zëdhënësi i LV-së ka dhënë përgjigjen e saktë, derisa ka shtuar se qytetarët e dinë se pse Radoiqiqi tash po ikën e dikur ishte në kryeministri. "Unë vetë nuk i kam dëgjuar, por qytetarët e dinë se kush ka bashkëpunuar me Radoiqiqin, dhe e kanë shumë të qartë pse Radoiqiqi ka ikur tash dhe dikur ishte në kryeministri. Për këtë zëdhënësi i

subjektit ku unë jam kryetar, pra i LV-së, Arlind Manxhuka, e ka dhënë përgjigjen e saktë", ka thënë Kurti.

Kryeministri para gazetarëve shtoi se "ajo është një situatë e montuar dhe Radoiqiqi këtë muaj i bënë 9 muaj që ndodhet i lirë në Serbi dhe trysnia do të duhej të ishte që të ketë aktakuzë ndaj tij".

Teksa u pyet edhe nëse do të

merren masa ndaj Kusari-Lilës, Kurti tha "po e kuptoj që po përpinqeni të dramatizoni me çdo kusht disa sekonda prej një bisede që nuk e di si është marrë e ku është marrë, si u pre e nga kush u organizua. Por edhe një herë unë jam kryetar i LV-së dhe Mimoza Kusari nuk është anëtare e LV-së. Edhe po të ishte anëtare e LV-së për kësos gjérash ka komisione, nuk e ka LV-ja kryetarin diktator që merr vendime siç do të kishte dëshiruar ndokush".

Ndaj deklaratës së Kurtit, se më herët Radoiqiqi është pritur në kryeministri, duke aluduar në pritjen që i kishte bërë Haradinaj si kryeministër në kohën kur Radoiqiqi ishte nënkyetar i Listës Serbe, lideri i AAK-së ka theksuar se Kurtit është duke i rënë maska. "Po të bie maska, Albin! Dil e trego pse kërkove partneritet me Radoiqiqin kur e

ke ditur se ai ka qenë i ndjekur nga organet e rendit dhe i arratisur nga Kosova që prej nëntorit 2018, e në Listën e Zezë të Amerikës prej dhjetorit 2021?", ka shkruar Haradinaj. Ish-kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga Kurti të përgjigjet në disa pyetje të vjetra, se si më 17 janar të vitit 2004 në Dollc të Klinës u gjet i mbuluar me batanije në një makinë me agjentë serbë Gollub e Boban Donqiq. "Po ashtu, ende nuk je përgjigjur në një pyetje shumë të vjetër. Pse vite pas lirimit të vjetës, më 17 janar 2004, në Dollc të Klinës u gjete i mbuluar me batanije, në makinë me agjentë serbë Gollub e Boban Donqiq? Përgjigju, Albin! Nuk mund të gënjesht më e as të fshihesh pas patriotizmit që asnjëherë nuk e ke pasur. Po të vjen fundi, Albin!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

### Prishja e raporteve, Kurti: Me presidenten Osmani ndonjëherë kemi edhe dallime

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se kanë bashkëpunim të ngushtë me presidenten Vjosa Osmani por, sipas tij, ndonjëherë kanë dallime dhe diskutime, por të cilat nuk janë të patejkalueshme. "Ne kemi bashkëpunim të ngushtë. Kjo nuk do të thotë se edhe me kryeparlamentarin Konufca dhe ministren e Jashtme Gërvalla dhe presidenten Osmani nuk kemi pasur diskutime dhe, ndonjëherë, dallime. Por nuk besoj se ka të tilla të cilat janë të patejkalueshme", tha Kurti.

Kreu qeveritar, pasi u kthye nga vizita në Turqi, tha të martën para gazetarëve se korporata turke Baykar që prodhon dronin "Bayraktar" është një adresë e duhur për blerje të armatimit për FSK-në. "Unë bashkëpunoj shumë ngushtë për të gjitha blerjet ushtarake me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe me komandantin e FSK-së, Bashkim Jashari. Sigurisht se ne do të vazhdojmë me pajisje moderne për ushtrinë tonë. Kemi dyfishuar shpenzimet përmbrnjte, trefishuar për armatim, katërfishuar për trajnime jashtë vendit.

Korporata Baykar që prodhon dronin Bayraktar padyshim se është një adresë e duhur që duhet të kemi përherë parasysh për zhvillimin e mëtutjeshëm të ushtrisë sonë. Por çfarë pajisjesh, kur do t'i blejmë dhe sa? Kjo mund të merret vesh në



të ardhmen", theksoi Kurti. I pyetur për deklaratën e ministrit të Infrastrukturës, Liburn Aliu, se nuk është dashur të pozicionohet për zgjedhjet në Luginë të Preshevës, ai tha se LV-ja ka qëndrim të qartë dhe vendimet se kënd duhet mbështetur i merr në organet e veta. Sipas tij, të gjitha partitë në Kosovë dhe Shqipëri mbështesin kandidatë të caktuar për zgjedhjet në Luginë. "LV-ja e ka qëndrimin e qartë dhe merr vendimet në organet e veta. Ne kemi mbështetur edhe Shap Kamberin në zgjedhjet parlamentare. Aty nuk ka qenë

vetëm një bllok, por dy blloqe dhe ne jemi përcaktuar ta mbështesim bllokun ku ka qenë Shap Kamberi. Unë jam kryeministër, por jam kryetar edhe i LV-së. Ju e dini se unë flas publikisht se kush duhet mbështetur edhe në BE dhe ShBA e lëre në Luginë dhe Ulqin. Jo vetëm kaq. Duhet theksuar se të gjitha partitë në Kosovë dhe Shqipëri mbështesin kandidatë të caktuar", ka deklaruar Kurti. Sa ii përket masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian, Kurti tha se ato duhet të hiqen sa më parë.

# Sadik Durakut i vazhdohet masa e paraburgimit në Serbi, sipas avokatit të tij

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Shtetasit të Kosovës, Sadik Durakut, i është vazhduar masa e paraburgimit në Serbi edhe për 30 ditë, ka thënë avokati i tij, Goran Petronijeviq, në disa përgjigje për Radion Evropa e Lirë.

Duraku - i cili ka edhe shtetësi britanike - është arrestuar më 17 prill të këtij viti në pikën kufitare mes Kroacisë dhe Serbisë.

Sipas autoritetet serbe, ai dyshohet se ka kryer veprën penale "krim lufte kundër popullatës civile".

Autoritetet serbe dyshojnë se Duraku, "së bashku me persona të panjohur, gjatë vitit 1999, në zonën e komunës së Gjakovës, Prizrenit dhe Pejës, si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka rrahur, fizikisht, ka ngacmuan mendërisht dhe ka grabitur popullatën civile".

Avokati i tij, Petronijeviq ka thënë se masa e paraburgimit i është vazhduar për shkak të rezikut të arratisjes, meqë

Duraku është shtetas i huaj dhe nuk jeton në Serbi.

Ai ka thënë se prokuroria është shumë pasive në këtë rast dhe nuk e ka marrë asnjë vendim që një muaj e gjysmë. "Prokuroria, me pasivitetin e saj, na detyron si mbrojtje të dëshmojnë se ai nuk është fajtor. Sipas meje, provat e mbledhura nga Prokuroria nuk vërtetojnë në asnjë mënyrë pretendimet e tyre", ka thënë ai.

Petronijeviq ka thënë se Duraku ka qëndruar vazhdimesh në Britaninë e Madhe, që nga dhjetori i vitit 1998, dhe se nuk është kthyer në Kosovë deri në vitin 2004.

Edhe Avdyl Duraku, vëllai i Sadikut, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se ai ka jetuar në Angli me familjen e tij qysh para se të niste lufta. "Në Kosovë për herë të parë pas lufte ka ardhur në vitin 2004", ka thënë ai, derisa ka treguar se gjendja shëndetësore e Sadikut nuk është e mirë, pasi po vuani prej problemeve në zemër. "Shpreso



të dalë gjallë, ky është halli im, sepse ai nuk është mirë me shëndet", ka thënë mes tjerash Avdyl.

Sadik Duraku është vetëm njëri prej qytetarëve të Kosovës që janë duke u mbajtur në paraburgim në Serbi, vjetëve të fundit.

Më 1 qershori, autoritetet serbe e kanë ndaluar edhe Tefik

Mustafën në pikëkalimin mes Kosovës dhe Serbisë, Merdare, nën dyshimet se ka kryer krim lufte kundër popullatës joshqiptare gjatë luftës në Kosovë, më 1999.

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë ka bërë të ditur se Mustafa, si pjesëtar i Mustafës si arbitrar dhe ka kërkuar ndihmën e faktorit ndërkombëtar përlirim i tij.

dëshmitarëve si pjesëmarrës në kidnapimin e tre policëve në qershori të vitit 1999 në Kosovë, "pas të cilit u humbën të gjitha gjurmët".

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës e ka konsideruar arrestimin e Mustafës si arbitrar dhe ka kërkuar ndihmën e faktorit ndërkombëtar përlirim i tij.

## Në prag të zgjedhjeve, BE-ja thotë se Rusia po përhap dezinformata

**BRUSEL, 4 QERSHOR** - Qeveritë evropiane thonë se Rusia po përhap dezinformata përparrë se Bashkimi Evropian t'i mbajë zgjedhjet për Parlamentin Evropian nga data 6 deri më 9 qershor. Ato thonë se veprimet e Moskës dhe të aktorëve pro Kremlinit janë pjesë e një fushate më të gjerë ndërhyrjesh, të krijuar për t'i diskredituar qeveritë evropiane dhe për ta destabilizuar BE-në.

Moska, në anën tjetër, i hedh poshtë akuzat.

Akuzat për ndërhyrjen e Rusisë në çështjet e BE-së, në prag të zgjedhjeve, përfshijnë dezinformimin apo manipulin e së vërtetës, thonë ekspertët. Sipas tyre, kjo bëhet duke filluar nga përforcimi i teorive tashmë ekzistuese të konspiracionit deri te publikimi i videove të falsifikuara dhe gjenjeshtrave në faqet 'doppelganger' - të krijuara për t'u dukur identike me faqet e vërteta.

Republika Çeke tha se ueb-faqja e lajmeve voiceofeurope.com ka udhëhequr një operacion të ndikimit prorus në Evropë. Një politikan dhe biznesmen ukrainas, por pro-rus, i identifikuar si Viktor Medvedchuk, i ka financuar në mënyrë të fshehtë operacionet e ndikimit të kësaj faqje. Belgjika, në anën tjetër, tha se zyrtarë rusë kanë paguar ligjvénës të Parlamentit Evropian për të



promovuar propagandë ruse në Evropë.

### Si u përgjigjet Rusia akuzave për ndërhyrje?

Rusia mohon se përhap dezinformata. Ajo thotë se Perëndimi është i përfshirë në një luftë informacioni në shkallë të plotë, që përfshin pretendime të rreme, të krijuara për ta shkatërruar reputacionin e Rusisë dhe përta paraqitur atë si armike. Zyrtarët rusë thonë se Perëndimi është bërë aq jotolerant saqë refuzon të pranojë çdo pikëpamje që bie ndesh me narrativin mbizotëruese dhe ka ndaluar transmetimin e disa medieve shtetërore ruse, si agjencia e

lajmeve RIA Novosti dhe gazetat Izvestia dhe Rossiyskaya Gazeta.

### Çka janë uebfaqet e rreme dhe 'doppelganger'?

Uebfaqet e rreme, apo 'deepfakes', janë media sintetike, në të cilat një person në një fotografi ose video ekzistuese, zëvendësohet me dikë tjetër duke përdorur teknika të inteligjencës artificiale. 'Deepfakes' mund të duken shumë reale dhe kjo ka çuar në përhapjen e dezinformative dhe të propagandës. Në zgjedhjet në Slloveni më 2023 u shfaq një regjistrim zëri i Michal Simecas, udhëheqësit të partisë Sllovakia Progresive, me sa duket

duke diskutuar për manipulin e votave. Regjistrimi ishte i rrëmë.

'Doppelganger' është emri që i atribuohet një fushate dezinformimi, që përfshin krijimin e ueb-faqeve të rreme, që ngjajnë shumë me pamjen e burimeve ekzistuese të lajmeve. Ueb-faqet e shënjestrurara përfshijnë gazetat e përditishme Le Figaro dhe Die Welt, si dhe ato të Ministrisë së Jashtme franceze dhe Ministrisë së Brendshme gjermane.

Një artikull në një faqe interneti të klonuar të Ministrisë së Jashtme franceze pretendonte se Franca po përgatiste një takse për t'i ndihmuar përpjekjet luftarake të Ukrainës. Rreth 200 llogari në Facebook u krijuan përmes një shqetësimi të partisë Sllovakia Progresive, me sa duket

çka thonë udhëheqësit e BE-së për ndërhyrjen e dyshuar ruse?

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se Evropa përballet me një zgjedhje të ashpër: të jetë e fortë ose t'u nënshtrohet autoritarëve. "A duam një Evropë të fortë, që lufton për vlerat dhe demokracinë tonë? Apo, a do të lejojmë që demokracitë tona të rrëmbehen nga marionetat e autoritarëve?", pyeti ajo.

Si i rregullon BE-ja mediet sociale?

Ligji i ri i Shërbimeve Digitale i BE-së kërkon heqjen e shpejtë të përbajtjes së paligjshme dhe më shumë informacione mbi mënyrën se si krijohet përbajtja. Platformat, si Facebook, YouTube e TikTok, kanë ndërmarrë masa duke krijuar ekipe për të luftuar dezinformimin, abuzimin me inteligjencën artificiale dhe ndikimin e fshehtë në zgjedhjet e Parlamentit Evropian. Në muajin prill, Komisioni Evropian, që është krahë ekzekutiv i BE-së, ka nisur hetime të Facebookut dhe Instagramit, për shkak të shqetësimeve se nuk kanë bërë mjaftueshëm për të luftuar dezinformimin. (Reuters / Rel)

## KEDS-i investon në Sferkë të Klinës 75 mijë euro

**KLINË, 4 QERSHOR** - Pak pa mbërritur tek Ujëvarat e Mirushës, nga ana veriore e tyre shtrihet fshati piktoresk i Sferkës. E njohur edhe si Sferka e Gashit, pasi thuajse krejt banorët e bartin këtë mbiemër, ajo është e ndërtuar në një relief me kontraste të mëdha, ku karakteristikë janë gurët e saj në një zonë kodrinore-malore. Për ta rritur atraksionin e këtij fshati të Klinës është përkujdesur së fundmi edhe KEDS-i, duke bërë investime masive aty. Kompania aty ka shtrirë mbi 7

mijë metra rrjet të ri, si të tensionit të mesëm, ashtu edhe të ulët. Ky investim ka gjëzuar tej mase edhe sferkasit. Veterani i arsimit, Aziz Gashi, thotë se KEDS-i në fshatin e tyre ka bërë një punë të mrekullueshme dhe për këtë i është shumë mirënjoës. "Për këto të mira që na ka sjellë KEDS-i jam në gjendje tri orë të flas. Kemi qenë në hall, shtyllat i kemi pasur të viteve '60 dhe shpesh na digjeshin fazat e rrymës. Tash jemi shumë të kënaqur se gjithçka është bërë më mirë", shprehet

i emocionuar Gashi. Ky nuk është investimi i vetëm që ka bërë së fundmi kompania në komunën e Klinës. KEDS-i ka shtrirë rrjetin e ri edhe në shumë fshatra të Klinës, duke bërë që banorët e asaj ane të marrin shërbime më kualitative dhe më të sigurta. Investimet e tillë, të nisura para 11 vjetësh, nuk janë ndalur asnjëherë dhe po bëhen në të gjithë territorin e Kosovës. Falë tyre, rrjeti distributiv po modernizohet gjithnjë e më tepër duke arritur në standartet më të larta.



## ATK-ja vlerësohet për ngritjen e përmbytjes tatimore dhe menaxhimin e rreziqeve fiskale

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Progresi i Administratës Tatimore të Kosovës në mbledhjen e të hyrave tatimore ndër vite po kontribuon çdoherë e më shumë në rritjen e të hyrave buxhetore dhe mirëqenies së qytetareve të vendit. Këto arritje pasqyrojnë përkushtimin e vazhdueshëm të ATK-së për përmirësimin e shërbimeve dhe transparencës si dhe për mbështetjen tatimpagueseve në kryerjen e obligimeve tatimore me kohë dhe saktë.

Administrata Tatimore ka arritur të mbledhë të hyra tatimore, duke tekaluar parashikimet dhe objektivat e planifikuar. Suksesi i atribuohet një sërë faktorësh, duke përfshire reformat e realizuara vitet e fundit, si dhe automatizimin e proceseve të punës, të cilat kanë lehtësuar përmbytjen e detyrimeve tatimore, duke rritur efikasitetin dhe zvogëluar burokracinë. Njëkohësisht, është punuar shumë në fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të vazhdueshëm tatimore të tatimpagueseve, gjë që ka rezultuar me rritjen e përmbytjes vullnetare dhe



zvogëlimin e evazionit fiskal. Po ashtu, me forcimin e kontrolleve dhe inspektiveve, përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe inspektimeve ka ndihmuar në identifikimin dhe korrigimin e parregullsive në mënyrë efektive. Të gjitha këto reforma janë vlerësuar pozitivisht edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare. I fundit është edhe vlerësimi i bërë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), në të cilin theksohet trendi i ngritisë së përmbytjes tatimore dhe menaxhimi i rreziqeve fiskale.

Përgjatë këtyre viteve raportet e institucioneve kredibile ndërkombëtare kanë vlerësuar lart punën dhe angazhimin e

ATK-së me theks të veçantë: transparencën dhe llogaridhjen, digitalizimin e shërbimeve, përparimet në investigimin e rasteve për evazion fiskal, konsolidimin dhe trajtimin e borxheve tatimore, si dhe reformat në rimbursimet tatimore etj. Administrata Tatimore e Kosovës është e përkushtuar ta vazhdojë përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve të saj, me qëllim rritjen e mbledhjes së të hyrave dhe përmirësimin e klimës ekonomike të vendit. ATK-ja ka theksuar se është e inkurajuar nga vlerësimet pozitive ndërkombëtare dhe do të vazhdojë të punojë për të arritur rezultate edhe më të mira në të ardhmen.

## Rama: Funksionalizimi i kamerave të sigurisë do të rritë sigurinë e përgjithshme në kryeqytet

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, thotë se funksionalizimi i kamerave të sigurisë në kryeqytet do të ndikojë në rritjen e sigurisë së përgjithshme. Rama pohon se do të respektohet maksimalisht privatësinë e qytetarëve tanë", ka theksuar Rama.



## KCSF lanson fazën e dytë të Programit EJA Kosovë dhe jep Çmimin për Demokraci 2023

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ka mbajtur të martën ceremoninë e lansimit të fazës së dytë të programit EJA Kosovë si dhe ndarjes së Çmimit për Demokraci për vitin 2023.

Në prani të përfaqësuesve të shoqërisë civile, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, korit diplomatik në Kosovë, partnerëve dhe bashkëpunëtorëve, u shënua vazhdimi i bashkëpunimit në përkrahje të shoqërisë civile në Kosovë.

Faza e dytë e programit EJA Kosovë vazhdon të bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia dhe përfshin rreth 200 grante në një shumë të përgjithshme prej rreth 2.5 milionë eurosh për pesë vitet e ardhshme si përkrahje për organizata joqeveritare, nisma të paregjistruese dhe individë që angazhohen drejt nxitjes së një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe demokratike. Po ashtu, KCSF i ndau

Çmimin për Demokraci 2023 aktivistes së shoqërisë civile Kosovare Sadiku, e cila ka punuar në zgjerimin e mundësive drejt pranimit dhe integrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar si të barabartë me moshatarët e tyre përmes krijimit të hapësirave publike gjithëpërfshirëse. Sadiku së bashku me bashkëpunëtorët e saj gjatë vitit 2023 për herë të parë në Prishtinë kanë krijuar kënde të lojërage përfshirë me aftësi të kufizuar.



OPINION NGA EC MA NDRIESHE


# Qytetet e mëdha të Kosovës po i ndiejnë efektet e ndryshimeve klimatike

Qytetet në rruzullin tokësor, sipas raporteve të ndryshme të organizatave ndërkombëtare, po nxehen dyfish mbi normën mesatare globale për shkak të urbanizimit të shpejtë dhe efektit të ishullit të nxehtësisë urbane. Ky trend është duke prekur edhe qytetet e mëdha të rajonit. As qytetet e mëdha të Kosovës nuk bëjnë përjashtim.

Sipas një raporti të Bankës Botërore që përqendrohet në Gjelberimin e Qyteteve, nxehtësia ekstreme në qytetet e Ballkanit Perëndimor është përveç qytetit të Ballkanit Perëndimor, që është përqendruar ndjesëm dhe valët e tij. Aty theksohet se Tirana, Shkodra, Vlora, Mostari, Sarajeva dhe Shkupi janë deri në 4.5-7.5°C më të nxehtë në verë krahasuar me rrethinat e tyre rurale.

Përveç kësaj, sipas raportit, shumë qytete të rajonit, përfshirë Shkupin, Tetovë, Sarajevë, Beogradin dhe Prishtinën përballen edhe me përqendrime të rritura të PM2.5 dhe janë ndër më të ndoturit në Evropë për sa i përket cilësisë së ajrit, që ka efekte negative në mjedisin e shëndetit e njerëzve. Edhe zgjerimi urban në shpatet e pjerrëta i ka bërë qytetet më të mëdha në Ballkanin Perëndimor të eksposohen ndaj rreziqueve të larta të rrëshqitjes së dheut. Ndërkohë, edhe reziku i përmbytjeve urbane, të shkaktuara nga reshjet intensive, ka ardhur në rritje në të gjitha vendet e rajonit në dekadat e fundit, duke çuar në dëme të konsiderueshme dhe humbje ekonomike.

Raporti rekomandon veprim në tre fronte kryesore për t'i bërë qytetet më të gjelber. Së pari, të zvogëlohet shtrirja urbane dhe qytetet të bëhen më kompakte. Kjo mund të bëhet



nëpërmjet investimeve për rigjenerimin e zonave urbane për të rritur dendësinë, inkurajimin e përdorimit të përzier të tokës në zonat kryesore dhe rizhvillimin e hapësirave tashmë të përdorura. Së dyti, qytetet duhet të ulin emetimet e tyre. Fokusi duhet të jetë në sektorët kryesorë duke përfshirë transportin, ndërtuesit dhe menaxhimin e mbetjeve. Së terti, qytetet duhet të ndërmarrin veprime për të zvogëluar nxehtësinë ekstreme urbane dhe për të rritur gatishmërinë për të. Masat, të tilla si çatitë e gjelbra, parqet dhe kopshtet urbane, dhe ligatinat e ndërtuara, duhet të promovohen duke pasur parasysh kostot e tyre të ulëta të zbatimit dhe përfitimet e larta

mjidisore dhe sociale. Në këtë pikëpamje, në raportin e Bankës Botërore, përmendet se sipërfaqet e gjelbra janë përmirësuar në rajon, ndonëse në periudhën e viteve 2015 - 2020 në qytetet si Tiranë, Tetovë dhe Prizren është vërejtur ulja e sipërfaqeve të gjelbra.

Për më shumë pohohet se investimet potenciale në gjelberim mund të sjellin dobi të larta.

Kosova, ashtu siç është cekur edhe në raportin e fundit të BE-së, duhet që të rrisë përkushtimin politik dhe kapacitetet administrative për ti adresuar çështjet që ndërlidhen me degradimin e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, sikurse edhe për të përmirësuar

zbatimin e ligjit, në përputhje me qellimet e Agjendës së Gjelber për në Ballkanin Perëndimor. Autoritetet qeveritare kanë formuar Këshillin Kombëtar për Ndryshime Klimatike që është përgjegjës për përcjelljen e zbatimit të dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit për ndryshime klimatike, në përputhje me angazhimet në kuadër të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike, Marrëveshjes së Parisit, si dhe Agjendës së Gjelber për Ballkanin Perëndimor. Por aktualisht në Kosovë përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike mbetet sfidë pasi studimet specifike për trendet, parashikimet dhe ndikimet

klimatike janë të kufizuara. Gjithashtu problemet si shtimi i numrit të ndërtimeve të pakontrolluara që nga viti 1999, planifikimi jo i rregullt, shpyllëzimi dhe shfrytëzimi jo adekuat i tokave bujqësore, menaxhimi i paqëndrueshmë i ujit, trajtimi i pamjaftueshmë i ujërave të zeza, energjia, transporti dhe mungesa e ndërgjegjësimit publik për mjedisin po kontribuojnë në degradim të mjedisit në tërë Kosovën, e të gjitha këto pastaj kanë ndikim në klimë dhe ndryshimin e saj.

Në këtë pikëpamje, një hulumtim i mëhershëm i EC Ma ka vënë në pah se qytetarët e Prizrenit në përgjithësi kanë vërejtur ndryshime në klimë dhe konsiderojnë se kjo në të ardhmen do të ketë pasoja tek ta. Madje 83 për qind të anketuarve janë përgjigjur se kanë vërejtur ndryshime në reshje, në ndërrimin e stinëve, përmbytje e thatësira.

Në të njëjtën kohë, EC-i ka publikuar edhe udhëzuesin për vendimarrësit të titulluar "Drunjtë në peizazhin e qytetit" ku theksohet se drunjti janë pjesë e zgjidhjeve për shumë çështje aktuale nga ndryshimi klimatik deri të shëndeti e mirëqenia, dhe se shërbijnë për restaurimin mjedisor dhe baraspeshën shoqërore në lagjet dhe qendrat e qyteteve.

Prandaj duke marrë për bazzë zhvillimet aktuale rekomandimi për autoritetet përgjegjëse është rritja e sipërfaqeve të gjelbra urbane sidomos me drunj meqë ato ndihmojnë luftimin e ngrohjes globale, duke thithur dyoksid karboni dhe duke liruar oksigen. Po ashtu krijojnë edhe habitate për shumë specie si dhe ndihmojnë shëndetin fizik dhe mendor të komunitetit.

## Kurti vizitoi fabrikën ku prodhohen dronët Bayraktarë, Baykar



**STAMBOLL, 4 QERSHOR** - Kryeministri Albin Kurti, gjatë qëndrimit në Stamboll, vizitoi fabrikën e prodhimit të dronëve ushtarake, Baykar, ku u prit nga drejtori ekzekutiv, Haluk Bayraktar dhe drejtori i Teknologjisë, Selçuk Bayraktar.

Baykar është kompani pioniere turke në industrinë e mbrojtjes dhe avacionit. Ajo është kompania e parë turke që ka prodhuar fluturake ushtarake pa pilot apo dronë dhe është veçanërisht e njohur ndërkombëtarisht për prodhimin e dronëve Bayraktar TB-2. Kjo

kompani ka gjithsej 4 500 të punësuar, gjysma e të cilëve janë inxhinierë dhe mosha mesatare e të punësuarve është 29 vjet.

Kryeministri shprehu mirënjojhen e tij ndaj drejtuesve të kompanisë Baykar për mënyrën se si është trajtuar me prioritet të lartë çdo blerje e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Aty ai u njoftua për teknologjitet e reja që kjo kompani po zhvillon dhe pa nga afër prototipin e fluturakes luftarakë pa pilot, Kizilelma. Në korrik 2023, kryeministri Kurti, bashkë me atëherë ministrin e

Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, kishin paraqitur dronët Bayraktarë TB-2 si pjesë e arsenalit të ushtrisë sonë.

Në nëntor të po të njëjtë vit, ministri i tanishëm i Mbrojtjes, Ejup Maqedoni, kishte dekoruar drejtorin ekzekutiv Haluk Bayraktar me medaljen "Shërbim të Shquar", që njëherësh është edhe çmimi më i lartë ushtarak në vendin tonë për vullnetin, gatishmërinë dhe bashkëpunimin me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

## Riten të hyrat e qeverisë në tremujorin e parë kahasuar me vitin e kaluar

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare për tremujorin e parë (TM1 2024). Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe. Gjithsej të hyrat e qeverisë së përgjithshme në TM1 2024 ishin 679.7 milionë euro, ndërsa të hyrat në TM1 2023 ishin 675.8

milioni euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatumet në produkte, të cilat paraqesin 76 % të totalit të të hyrave, tatumet rrjedhëse në të ardhura 18 %, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategoritë tjera të të hyrave. Gjithsej shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në TM1 2024 ishin 601.6 milionë euro, ndërsa

shpenzimet në TM1 2023 ishin 511.8 milionë euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kompensimi i punëtorëve me 33 %, kontributet sociale dhe përfitimet me 27 %, konsumi i ndërmjetëm 13 %, formimi i kapitalit bruto 8 %, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategoritë tjera të shpenzimeve.



## Ismaili dhe Kastrati diskutojnë për avancimin e përpilimit dhe raportimit statistikor nga standardi GDDS në SDDS

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim pune ushtruesin e detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Avni Kastrati.

Guvernatori Ismaili e njoftoi Kastratin për aktivitetet e BQK-së në funksion të realizimit të objektivave të saj dhe aktivitetet në proces lidhur me reformat në fushën e përpilimit të statistikave financiare dhe arritjet e rëndësishme në zhvillimin e statistikave të llogarive financiare. Një vëmendje iku kushtua edhe projektit për Indeksin e Çmimeve të Patundshmërisë që udhëhiqet nga ASK-ja e që mbështetet nga BQK-ja në kuadër të programit të Republikës së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar.



Po ashtu, guvernatori Ismaili dhe Kastrati diskutuan lidhur me përkushtimin për avancimin e përpilimit dhe raportimit statistikor nga standardi GDDS në SDDS, avancim ky që po mundësohet edhe me përkrahjen e FMN-së. Ismaili e njoftoi të parin e ASK-së

për zotimin e BQK-së për adaptimin e standardit GDDS (General Data Dissemination System apo Sistemi i Përgjithshëm për Shpërndarjen e të Dhënavë) në SDDS (Special Data Dissemination System apo Sistemi i Veçantë për Shpërndarjen e të Dhënavë).

Në takim u diskutua lidhur me marrëveshjen e re të mirëkuptimit ndërmjet BQK-së, ASK-së dhe Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve, e cila do t'i adresojë rolet dhe përgjegjësitë për përpilimin, shpërndarjen, shkëmbimin e të dhënavë si dhe për të ofruar mbështetje reciproke

me fokus në fushat kyçë në të cilat posedohet ekspertizë dhe qasje optimale në të dhëna.

Gjatë këtij takimi, guvernatori Ismaili dhe Kastrati shprehën gatishmërinë ta zgjerojnë bashkëpunimin ndërmjet BQK-së dhe ASK-së në fushën e statistikave si një nivel të përgjithshëm, ashtu edhe për projekte specifike në funksion të avancimit të përpilimit dhe publikimit të të dhënavë statistikore, me transparencë dhe shpalosje adekuate. Në fund të takimit, guvernatori Ismaili përgëzoj drejtuesin e ASK-së për përfundimin me sukses të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, duke potencuar rëndësinë që këto të dhëna sapo të publikohen do të kenë për politikat dhe vendimarrjen e bazuar në të dhëna të tilla.

## Forumi ekonomik Kosovë - Turqi u ndoq nga 200 biznese, potencial i fortë i bashkëpunimit

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Në Oda Ekonomike e Izmirit dhe Shoqata Kosovare për Arsim është organizuar forumi ekonomik "Ditet e biznesit kosovar". Ngjarja u ndoq nga 200 biznese nga Izmiri, duke treguar potencialin e fortë për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Turqisë. "Ne shprehim falënderimet tona të sinqerta për përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Izmirit, Shoqatës Kosovare për Kulturë dhe Edukim për mbështetjen dhe kontributet e tyre të paçmueshme. Pjesëmarrja e një numri kaq të madh biznesesh është

një konfirmim i qartë i gatishmërisë dhe entuziazmit për të bashkëpunuar me vendin e të parëve", ka thënë kryetari i Odes Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna.

Ndërsa Besim Mustafa, drejtor për Bashkëpunim Ndërkombëtar, ka bërë me dije se u zhvilluan diskutime të frytshme me komunitetin e biznesit të Izmirit, duke theksuar mundësitet për investime dhe bashkëpunim në sektorë të ndryshëm si energjia, miniera dhe prodhimi. "Kompanitë e biznesit nga Izmiri bënë shumë



pyetje rrith mundësive të investimit në Kosovë, duke treguar një interes të madh për t'i eksploruar këto mundësi më tej. Paraprakisht këtij diskutimi i parapriu prezantimi mbi promovimin e Kosovës dhe mundësitet që jep ky vend", ka thënë Mustafa.

Në fund të forumit ekonomik në Izmir, të gjithë ranë dakord për të organizuar një vizitë të bizneseve nga Izmiri në Kosovë, duke forcuar më tej lidhjet tona dhe duke eksploruar mundësi të reja për bashkëpunim.

## Ministria e Financave fton punëdhënësit dhe punëkërkuesit në veri të regjistrohen për të aplikuar për masën e punësimit

**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Qeveria e Republikës së Kosovës fton të gjithë punëdhënësit dhe punëkërkuesit në komunën Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe

Zveçan, të regjistrohen në zyrat e punësimit në komunat e tyre për të aplikuar për masën e punësimit për qytetarët e këtyre katër komunave. Siç

thuhet në njoftim, masa ofron mundësinë e subvencionimit të 70 % të pagës së punëtorëve të angazhuar për një periudhë prej gjashtë muajsh.



# Mashtrimi i madh britanik i Luftës së Dytë Botërore: Ushtria e madhe e cila nuk ekzistoi



Nga: Taylor DOWNING,  
autor i librit Ushtria që nuk  
ekzistoi: Dita-D dhe  
mashtrimi i madh [The Army  
that Never Was: D-Day and  
the Great Deception]

Përvjetori i ardhshëm i tetëdhjetë i Ditës-D [D-Day] është rast i mirë për të kujtuar heroizmin dhe guximin e njëzve që zbarkuan në plazhet e Normandisë më 6 qershor 1944 – në ngarjen e cila ndryshoi valën e Luftës së Dytë Botërore, kundër regjimit të Hitlerit.

Por, prapa suksesit të tyre shtrihet kontributi pak i njohur i burrave dhe grave nga industria e filmit. Ata ndihmuin në mashtrimin e armikut, për të menduar ata se pushtimi do të ndodhë në Pa-de-Kale – përgjatë kalimit më të shkurtër të La-Manshit. Dhe, edhe pas zbarkimit të Normandisë, Komanda e Lartë Gjermane vazhdoi të besonte se ky nuk ishte asgjë tjetër veçse diversion dhe se ende nuk ka ardhur invadimi i dytë më i madh.

## Si lindi ky mashtrim, Operacioni Qëndresa [Operation Fortitude]?

Historia nis në vjeshtën e vitit 1940, kur koloneli John Turner nisi ndërtimin e fushave të rrejshme ajrore, për të ngatëruar aviacionin gjerman [Luftwaffe] për

madhësinë e mbrojtjes luftarake të Britanisë. Turner ishte drejtor i Punimeve dhe Ndërtesave në Ministrinë Ajrore, duke ndihmuar në ndërtimin e pistave të reja të Forcave Mbretërore [RAF] gjatë mobilizimit të shpejtë të para Luftës. Doli në pension në vitin 1939, por u ftua për të drejtuar departamentin e ri top-sekret – për të ndërtuar fusha të rreme ajrore dhe për t'i mbushur ato me maketa të aeroplani.

Mareshali i aviacionit, Sir Hugh Dowding – shef i Komandës Luftarake të RAF-it – ishte kundër

punës së Turnerit. Ai nuk donte që burimet të devijoheshin në mashtrime – kishte nevojë për luftëtarë të vërtetë dhe për baza të vërteta ajrore. Dowding tha se donte "substancë" jo "hije". Megjithatë, Ministria Ajrore i tha Turnerit që të vazhdojë. Por, problemi i Turnerit ishte se prodhuesit e aeroplani të ndërtuan aeroplanë të rremë që ishin shumë të sofistikuar dhe kompleksë për gjërat që thjesht duhej të shiheshin nga një aeroplan zbulimi që fluturonë në 6.1 kilometra lartësi. Ata gjithashtu

ishin shumë të shtrenjtë. Turneri kishte nevojë të gjente një furnizues të ri për maketet. Këtu futet në lojë Norman Loudoni. Në perëndim të Londrës, në fillim të viteve 1930, biznesmeni skochez Loudon kishte blerë një rezidencë me 30 hektarë tokë. Në vitin 1932 hapi një studio filmi në njediset e rezidencës Sheperton. Ndërtoi dy skena të mëdha, i pajisi me teknologjinë më të fundit për audio dhe ndërtoi dhoma të zhveshjes, gardëroba, punëtori dhe të gjitha pajisjet për realizimin e filmave. Duke ditur se kalimi në

filmat me zë është i përhershëm, studiot i quajti Qyteti i Zërit [Sound City].

Studiot Sheperton shpejt u treguan të suksesshme dhe deri në vitin 1939 ishin dyfishuar në madhësi. Qyteti i Zërit tërroqi disa nga kineastët më të mirë të asaj kohe, si producentin Alexander Korda, regjisoren Anthony Asquith dhe montazherin David Lean. Ekipi i teknikëve të talentuar të filmit – përfshirë stilistët, kostumografët dhe zdrukthëtarët – rritje për t'i shërbyer zhvillimit të rregullt të produksionit. Por, ardhja e Luftës solli rënienë të madhe në prodhimin e filmit britanik. Teknikët u thirrën përluftë, ndërsa ranë financat për prodhimin e filmit.

Gjatë vitit 1940, pas takimit me Loudonin, Turneri kuptoi se industria e filmit kishte përvojë në realizimin e rekuizitave të cilat ishin krejtësisht artificiale, por që dukeshin reale në kamerë. Ndoshta ata mund të ndërtistonin maketin e tij të aeroplani? Duke parë një mundësi biznesi për të krijuar punë për teknikët të cilët nga Sheppertoni kërkonin mbijetësen, Loudoni ofroi dhe fitoi kontratën për të ndërtuar 50 aeroplanë Wellington dhe 100 Blenheim. Kostoja ishte sa një e treta e asaj e ofruar nga prodhuesit e aeroplani. RAF-i u gjëzua, Turneri mori maketat dhe Loudoni e gjeti një punë të vlefshme në kohë luftë, për teknikët e tij të filmit. Ndërkohë, 3 219 kilometra larg, një



Pas invadimit të Ditës-D, Operacioni Qëndresa e vonoi vendosjen e rezervistëve gjermanë në Normandi, duke i bërë zbarkimet të dukeshin si sulm shpërqendrimi



Përmes taktikave të devijimit, si pajisjet e rreme, Operacioni Qëndresa kishte për qëllim të largonte vëmendjen e Boshtit nga Normandia

njësi e re u krijuar nga Ushtria Britanike në Kajro. Enjohur thjesht si Forca-A [A-Force], ajo drejtosej nga një tjetër pionier i mashtrimit – nga nënkoloneli Dudley Clarke. Clarke ishte person i gjallë, mjeshtër i fjalëve dhe e kishte një aftësi goxha të keqe meqë ishte në gjendje të hynte në dhomë pa e

vënë re askush ardhjen e tij. Ai nisi t'i mashtrojë italianët dhe gjermanët për qëllimet e aleatëve në Luftën e rrëmuishme të Shkretëtirës [Desert War] – e cila u zhvillua në Egjipt dhe në Libi. Disa nga mashtrimet e tij nuk funksionuan, por mësoi si nga sukseset ashtu edhe nga

dështimet. E kuptoi se që mashtrimi të jetë efektiv, ai duhej jo vetëm ta bënte armikun të mendonte diçka, por të bënte diçka – të linte forcat e veta në vendin e gabuar ose të largonte trupat nga fokusi i sulmit të ri. Dhe, shpejt u bë i zoti në artin e krijuar të forcave që nuk ekzistonin, në

ekzagjerimin e Urdhrit të Betejës [forcave të organizuara ushtarake]. E shpiku një brigadë parashutistësh dhe i bindi italianët se ata do të përdoreshin për të rënë prapa linjave të tyre. Por, nuk kishte trupa ajrore në Afrikën e Veriut. Vazhdoi të shpikte divizione dhe trupa ushtarake që dukej shumë më e madhe sesa në fakt ishte.

Në betejën e El-Alameinit në tetor 1942, Clarke dhe shokët e tij mashtrues e bindën armikun se sulmi aleat do të vinte nga jugu i frontit të betejës. I përdorën kamionët e mbuluar me materiale gome që dukej si tanke nga ajri, duke krijuar atë që dukej si gjurmë e tankeve nëpër rërë. Bënë që një depo imaginare karburanti në jug, të dukej si tubacion – punuar në fakt nga kazanët e vjetër të naftës. Gjermanët vendosën dy divizione të blinduara në jug për të përballuar këtë kercenim të dukshëm. Kur erdhi beteja, Montgomery sulmoi nga veriu i frontit të betejës. Beteja zgjati me 10 ditë luftimesh të rënda, por manovrimi i armikut padishim që ndihmoi në arritjen e fitores.

Kur është fjala për planifikimin e Ditës-D, operacioni më i madh amfib i nisur ndonjëherë, ishte edhe më e madhe nevoja për një plan të detajuar mashtrimi. Kur e diskutoi pushtimin me Josif Stalinin në Teheran, Winston Churchill përdori frazën: "Në kohë lufte, e vërteta është aq e çmuar saqë gjithmonë duhet të përcillet nga truproja e gënjeshtrave". Kjo në mënyrë të përkryer përmblidhje pikëpamjen aleate për mashtrimin.

Gjenerali Montgomery, i cili që nga Alameini ishte mbështetës i zjarrtë i mashtrimit, u vu në krye të Grupit të Ushtrisë XXI, duke e bërë atë efektivisht komandant të forcave

tokësore në Ditën-D dhe më gjérë. Shefi i tij i mashtrimit, nënkoloneli David Strangeways, këmbënguli se e vetmja mënyrë për t'i shtyrë gjermanët që të mbajnë ushtri të madhe të rajonin e Kalesë, Ushtrinë e tyre të XV, ishte t'i bindte ata se një grup i plotë ushtrie po formohej në Kent, Esekës dhe Suffolk, duke u përgatitur për të pushtuar përgjatë Pa-de-Kalesë. Por, si munden mashtruesit të trumbetojnë për ushtrinë prej 300 mijë burrave të cilët nuk ekzistonin?

Kishte shumë elemente në fushatën e mashtrimit të njohur si Operacioni Qëndresa. Agjentët e dyfishtë, spionët gjermanë që ishin dërguar në Britani, duke që ishin kthyer nga MI5-shi, dërguan keqinformime te eprorët e tyre gjermanë. Ata e luajtën një rol të madh. Kishte edhe mashtrime shkencore, duke dërguar sinjale të rrëme për të treguar se flotat e anijeve ose skuadriljet e aeroplanoftë ishin diku ku nuk ishin.

Por, për të krijuar një ushtri të rrëme, mashtruesit filluan me një emër – Grupin I të Ushtrisë Amerikane, i njohur me akronimin FUSAG. Edhe një herë, teknikët e filmit në Sheperton u vunë në punë për të ndërtuar tanket e rrëme për këtë ushtri të pretenduar. Të përbërë nga goma dhe kanavaca rrëth një kornize metalike, ato mund të fryheshin për 30 minuta. Me qindra u prodhuar dhe u rreshtuan në zona të mëdha montimi, njësoj si një jugperëndim ku ushtria e vërtetë po mblidhej për pushtimin e vërtetë. Ata e projektuan një mjet të madh zbarkimi të bërë nga kanavaca dhe nga druri i cili pluskonte nga rezervuarët bosh. Çdo realizim kishte nevojë për 30 vetë dhe gjashtë ose shtatë orë për t'u montuar. Dyqind e pesëdhjetë



Anije e rrëme e përdorur si karrem në portet juglindore para Ditës-D



**Pajisjet e rreme, si tanket, u përdorën nga Britania për të krijuar kërcënime invadimi në pjesë të tjera të Evropës Perëndimore**

u “nisën” përgjatë bregut juglindor, nga Doveri në Jarmuthin e Madh. Fatkeqësisht, edhe pse të ankoruar me një spirancë të rendë, kishin prirje të rrokuilliseshin nga era e fortë. Kompanitë e regimentit të Uorstesher u vunë në gatishmëri

për të nxituar për t'i kthyer në vend – sa më shpejt që ishte e mundur. Për më tepër, një depo e rreme karburanti u ndërtua pikërisht përgjatë bregut nga Doveri. E bërë nga dërrasat prej druri, skelat dhe tubacionet e vjetra të kanalizimeve

nga vendet e bombardimeve, dukej keq nga toka. Por, kryesorja, nga 6.1 kilometra dukej si e vërtetë. Disa divizione ekzistuese amerikane dhe kanadeze iu ndanë FUSAG-ut dhe disa divizione të reja u shpikën për të krijuar numrat

e përfshirë. Një njësi e plotë e sinjalëve të ushtrisë amerikane u udhëzua të dërgonte mesazhe të rreme, lart e poshtë në radiot e zinxhirit komandues, me detaje të ushtrimeve stërvitore dhe të zbarkimeve të rreme për në plazh. Gjermanët nuk kishin nevojë të deshifronin të gjitha këto mesazhe. Mund të vërenin nga vëllimi i trafikut në radio se ajo që dukej se ishte ushtri e madhe, po mblidhej në Anglinë juglindore. Deri në fund të majit, një javë përpëra Ditës-D, inteligjenca gjermane llogariti se 79 divizione aleate ishin mbledhur në Mbretërinë e Bashkuar. Në fakt, numri ishte vetëm 52.

Por, qdo ushtri ka nevojë për një komandant dhe në inskenim të shkëlqyer: gjenerali George S Patton u vu në komandën e FUSAG-ut. Pa dyshim, ai do të kishte preferuar të komandonte trupat e vërteta që përgatiteshin për pushtimin aktual, por u hodh në këtë rol të ri.

Si shoumen i madh, shfaqej duke mbajtur fjalime dhe duke inspektuar njësitë imaginare të këmbësorisë dhe të njësive të blinduara. Kudo që shkoi,

shoqërohej nga fotografët dhe komanda e tij e re shpejt rrondhi te armiku. Teksa gjermanët mendonin se ai ishte një nga gjeneralët më të mirë që kishin Aleatët, besonin plotësisht se ai do të komandonte trupat e invadimit në Evropë.

Kur zbarkimi i Ditës-D u zhvillua në Normandi, gjermanët u zunë në befasi të plotë. Por, reagan shpejt dhe, brenda pak ditëve, nga Franca jugore dhe perëndimore mbërritën përforcimet për të luftuar. Lufta gjashtëjavore për të çarë nga Normandia, ishte e gjatë dhe e vështirë. Megjithatë, kryesorja eshtë se Ushtria e XV gjermane mbeti në Pa-de-Kale duke pritur atë që Komanda e Lartë Gjermane ishte e bindur se do të jetë invadimi i dytë i madh. Derisa betejat vendimtare në perëndim zhvilloheshin në Normandi, më shumë se 150 mijë trupa gjermane rrinin kot 321 kilometra larg përreth Kalesë. Fushata e mashtimit, Operacioni Qëndresa, korri sukses mahnitës.

*Përkthimi: Agron SHALA / Telegrafi.com*



**Ideja e krijuar të formacioneve të rreme mashtruese, u krijuar në Kairo nga Forca-A (foto: Trajnimi i vullnetarëve të Shërbimit Special Ajror në Egjipt)**



# Sport



## Shënohet Ditën Botërore e Sportit dhe Ambientit në Kosovë



**PRISHTINË, 4 QERSHOR** - Komiteti Olimpik i Kosovës ka shënuar Ditën Botërore të Sportit dhe Ambientit duke shënuar aktivitet të ndryshme sportive në Prishtinë. Kjo ditë është konsideruar shumë e rëndësishme për ruajtjen e shëndetit, por edhe për mesazhin për ta ruajtur një ambient të pastër.

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, deklaroi se sporti ka një rol të jashtëzakonshëm në promovimin e shëndetit, edukimit dhe vlerave të mërëgenies sociale. "Sporti ka një rol të jashtëzakonshëm në promovimin e shëndetit, edukimit dhe vlerave të

mërëgenies sociale. Është një mjet i fuqishëm për të sjellë bashkë komunitetet, për t'i zhvilluar aftësitë profesionale dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë. Nga ana tjetër, mbrojtja e ambientit është një përgjegjësi që u përket të gjithëve që kërkon veprime të përbashkëta dhe të koordinuara", ka thënë Krasniqi. Kurse drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Iber Alaj, theksoi se ambienti duhet të ruhet nga të gjithë.

Drejtori i Drejtorisë së Sportit në komunën e Prishtinës, Bardh Krasniqi, ka thënë se do të mbështeten të gjitha aktivitetet sportive, por edhe ato për

ruajtjen e ambientit. Dita Botërore e Sportit dhe Ambientit u shënuat edhe me mbjelljen e Pemës Olimpike, e cila kësaj radhe u mboll në oborrin e Qeverisë së Kosovës. Kurti tha se mbjellja e Pemës Olimpike u bë në prag të Lojëra Olimpike, ku pesë xhudistë dhe një boksiere do ta përfaqësojnë Kosovën e të cilëve u uroi suksese. Më tej, Kurti shprehu falënderim që Pema Olimpike tashmë gjendet edhe në oborrin e Qeverisë së Kosovës. Në anën tjetër, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka deklaruar se, edhe pse simbolike, Pema Olimpike ka një domethënie shumë të madhe.

## Munishi paraqitet te Dukagjini

**KLINË, 4 QERSHOR** - Ismet Munishi është emëruar trajner i ri i skuadrës së Dukagjinit nga Klina. Prezantimi i Munishit është bërë dje. Në këtë klub e zëvendëson Armend Dallkun i cili është

larguar kohë më parë. "Në zyrat e klubit tonë është nënshkruar kontrata e bashkëpunimit me trajnerin e njohur Ismet Munishi, i cili ishte pjesë e disa skuadrave në Kosovë. Ismeti theksoi se është

i gatshëm ta udhëheqë ekipin. Premtoj punë dhe përkushtim maksimal, gjithashtu kërkoi mbështetje nga i gjithë qyteti i Klinës. Na prift e mbarë, Ismet Munishi!", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.



### SHKURT

#### Sylvinho: Shqiptarët dinë të shutojnë mirë nga distanca

Kombëtarja e Shqipërisë gjatë fazës kualifikuese për "Euro 2024" më së shumti u veçua për golat nga jashtë 16-metërsit. E pikërisht në lidhje me këtë, trajneri i kombëtares shqiptare, Sylvinho, u pyet nga BBC. "Ata me të vërtetë dinë ta godasin topin nga distanca, e kanë atë në vete dhe e duan atë, kështu që unë i inkurajoj ta bëjnë këtë. Nëse ata mendojnë se kjo është gjëja më e mirë për ta bërë, ju lutemi gjuani në portë!", ka thënë Sylvinho. Shqipëria në Evropian në fazën e grupeve do të ballafaqohet me Italinë, Spanjën dhe Kroacinë.

#### Juventusi dhe Roma në garë për transferimin e Zhegrovës

Dy klube janë në garë për transferimin e reprezentuesit të Kosovës, Edon Zhegrovës. Juventusi është i interesuar për sulmuesin anësor të Lilles, i lindur në vitin 1999. Lajmi konfirmohet nga "Tuttosport", gazeta sportive torineze shumë pranë klubit bardhezi. Sipas saj, Juventusi pritet të hyjë në negociata me agjentin e lojtarit kosovar Hasan Cetinkaya, me të cilin ka marrëdhëniet të shkëlqyera, duke qenë se është i njëjtë agjent që shiti Denis Zakarian për 20 milionë te Monaco. Mirëpo, edhe Roma është në gjurmët e Zhegrovës, ndërsa Napoli ka hequr dorë nga lojtari kosovar. Edon Zhegrovë ka luajtur për Standard Liege, St. Truiden, Genk, FC Basel dhe tash është pjesë e Lilles me të cilin klub ka kontratë deri në verën e vitit 2026.

#### Asllani: Fokusi ynë është në ndeshjen ndaj Italisë

Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Kristjan Asllani, foli pas fitores 3-0 në miqësoren me Lihtenshtejn. Mesfushori i Interit ka bërë me dije se i gjithë fokusit i kuqezinjve është në ndeshjen ndaj Italisë. "Kjo është një përgatitje. Janë ndeshje që të marrim benzinë në këmbë për ne që kemi luajtur më pak dhe kemi bërë një ndeshje të mirë, kemi qarkulluar mirë dhe kemi bërë 3 gola. 3 golat janë bërë nga sulmuesit që të marrin edhe ata besim. Kjo është një gjë shumë e mirë. Jemi një grup kompakt. Sot erdhë edhe kapiteni ynë Xhimi. Jemi përgatitur mirë për Evropianin dhe të arrijmë sa më mirë në ndeshjen e parë. Presim tifozët tanë në çdo ndeshje, i falënderojmë dhe ata që ishin me ne. Do të jetë një ndeshje si kjo, të marrim akoma benzinë në këmbë dhe fokusit është tek Italia. Sigurisht që do ta japim shpirtin dhe zemrën, por ajo që do të dalë nuk i dihet por, ashtu siç thashë, çunat po përgatiten mirë të gjithë po përgatitemi mirë që të dalim sa më mirë në ndeshjen e parë", ka deklaruar Asllani.

## Vasseur: Tashmë Ferrari është më afër Red Bullit

**MARANELLO, 4 MAJ** - Në tetë garat e para të këtij botërori të Formulës 1 surprizat kanë qenë të shumta. Por, më kryesorja është se Red Bull nuk është më një makinë e pathyeshme, pasi në tri gara kanë fituar dy herë

Ferrari e një herë McLareni, gjë që dukej e paimagjinueshme një vit më parë, kur Red Bulli fitonte me diferenca të mëdha. Këtë gjë e konfirmon Frederic Vasseur, shefi i Ferrarit, që në prag të garës së Kanadasë pret

sërisht rivalitetin në pistë: "Ata kishin një avantazh të madh një vit më parë, më shumë se 20 sekonda. Mund të kryen edhe një ndalesë më shumë se të tjerët e prapë do të ishin të parët. Ndërsa këtë vit bëhet

fjalë për të dhjetat epërsi që ata kanë ndaj nesh dhe e dinë se nuk mund të bëjnë asnje gabim. Tashmë disa gara janë mbyllur me pak të dhjetat diferençë, çka tregon se do të jetë një botëror i dueluar.



## Broja: Jam në superformë, dua ta ndihmoj Kombëtaren

**TIRANË, 4 QERSHOR** - Armando Broja duket se ka riqjetur formën e tij më të mirë, teksta ndaj Lihenshtejnit qëndroi në fushë për më shumë se 60 minuta, duke shënuar edhe golin e parë. Pas ndeshjes sulmuesi dha garanci se është gati për ta ndihmuar skuadrën në Evropian, teksta thuri elozhe edhe për trajnerin Sylvinho e grupin e futbollistëve kuqezi.

Ashtu si Asanin, edhe juve klubi nuk ju ndihmoi shumë për të luajtur këta muaj. Megjithatë kombëtarja duket se është shtëpia juaj, aty ku jepni maksimumin...  
**Broja:** Gjërat te klubi nuk shkojnë gjithmonë ashtu siç dëshiron. Janë zgjedhjet e trajnerit dhe duhet t'i pranosh. Kur vij këtu kam një emocion tjetër dhe kur bashkohem me çunat jap maksimumin. Kur luajmë lirshëm dhe kënaqemi në fushë, bëjmë një futboll të bukur.

Ajeni gati të jeni numri 9 i Shqipërisë në Evropian? Ajeni gati të dëfreheni dhe të bëni lojën që dinë?

**Broja:** Jam gati gjithmonë. Trajneri është ai që vendos, por unë jam gjithmonë gati të jap maksimumin kur të jem në fushë. Jam këtu për të bërrë punën time, të ndihmoj ekipin me gola dhe asistime. Jam këtu për të bërrë diferençën dhe shpresoj që të ndihmoj sa më



shumë skuadrën kombëtare.

Do të donim që të kishit ardhur më shumë minuta në Evropian, por jemi para këtij faktit. Amendooni se jeni 100% gati për ta përballuar Evropianin?

**Boja:** Fizikisht jam shumë shumë mire, pasi kam punuar shumë jo vetëm te skuadra, por edhe individualisht. Mund të them se jam kthyer në formën më të mire, ndoshta njësoj si para dëmtimit.

Sot mora rrëthenjë orë dhemund të rezistoja edhe më shumë, megjithatë trajneri donte të provonte edhe lojtarë të tjerë.

Kam parë videot tuaja, ku flisnit me shumë entuziazëm për Shqipërinë. A do të jetë ky një Evropian që do t'ju afrojë më shumë me skuadrën në aspektin e liderisë?

**Broja:** Únë kam munguar shumë

kohë për shkak dëmtimi, por të gjithë më mirëpritën kur u riktheva. Kam qenë me ta edhe më parë dhe shkoj mire me të gjithë. Rrimë bashkë edhe jashtë stërvitjes, pasi kemi ambient shumë të mire. Edhe trajneri na ka bashkuar shumë si ekip. Edhe tifozët më kanë dhënë shumë kënaqësi dhe entuziazëm, ndaj i falenderoj të gjithë që besojnë tek unë.

A është kjo loja dëfryese e përshtatshme për t'u përballur me kundërshtarë të fortë?

**Broja:** Ne kemi luajtur me ekipe shumë të forta dhe bukuria e futbolit është kur fiton ndaj tyre. Ne po përgatitemi shumë mire dhe jemi shumë të kënaqur, ndaj shpresoj që të bëjmë shumë mire ndaj tyre. Në 90 minuta diferençën e bëjnë detajet, ndaj jam i bindur që do të bëjmë mire.

## Rusia fushatë kundër Olimpiadës në Paris

**PARI, 4 QERSHOR** - E përjashtuar nga Lojërat Olimpike të këtij viti për shkak të luftës në Ukrainë, Rusia ka ngritur një fushatë të fshehtë ndikimi, duke këruar ta diskreditojë Olimpiadën dhe të mbjellë frikë nga terrorizmi. Ky është rezultati i një raporti nga njësia e inteligjencës së kërcënimive të Microsoftit. Raporti gjurmon ata që i quan "aktorë pjelloër të ndikimit rus", që verën e kaluar filluan të fokusohen në përcëminin e Lojërat Olimpike



2024 që zhvillohen në Paris dhe të presidentit francez Emanuel Macron. Në këto manovra është edhe dokumentari që paraqet një falsifikim të thellë të aktorit Tom Cruise. "Këto operacione të

vazhdueshme të ndikimit rus kanë dy objektiva qendrore: të denigrojnë reputacionin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC) në skenën botërore dhe krijimin e pritshmërisë së shpërthimit të dhunës në Paris gjatë Lojërat Olimpike Verore 2024", thuhet në raport. "IOC së fundmi është përballur me një numër postimesh të rreme të lajmeve që synojnë të godasin këtë institucion", thuhet në deklaratën e komitetit.

## Mourinho kritikon Guardiolan: Ai qesh me fatkeqësitet e klubeve të tjera

Jose Mourinho, i cili tashmë është prezantuar si trajneri i ri i Fenerbahçes, ka folur për disa skuadra të Premierë Ligës dhe ka shfrytëzuar rastin përfundimtar. Deklaratat e "Special One"

Raportet e Mourinhos me Guardiolan nuk janë më të mirat dhe këtë e tregojnë deklaratat e fundit të portugezit përfundoi me fitoren 2-0 të "Los Blancos". Mourinho ishte kritik përfundimtar e Guardiolanit.

kanë arrdhur në finalen e Ligës së Kampionëve mes Real Madridit dhe Borussia Dortmundit, e cila përfundoi me fitoren 2-0 të "Los Blancos". Mourinho ishte kritik përfundimtar e Guardiolanit.

qëndrimin e tij ndaj skuadrave të tjera të Premierë Ligës si Chelsea, Manchester United dhe Tottenham Hotspur. "Mendoj se në këtë moment Pep Guardiola po qesh me

katastrofën në klubet e tjera", ka deklaruar Mourinho përfundimtar. Ndryshtë, Mourinho është zyrtarizuar tashmë si trajner i ri i klubit turk Fenerbahçe.

## SHKURT

### Simone Biles fiton titullin e 7 botëror radhazi dhe vendos rekordin e jashtëzakonshëm në garë

Në kampionatin botëror të gjimnastikës që po zhvillohet në Teksas, ikona e këtij sporti, gjimnastja 27-vjeçare amerikane Simone Biles, fitoi titullin e shtatë radhazi në karrierën e saj. Jo vetëm kaq, por "mbretëresha" e gjimnastikës ka shkruar një faqe të re në historinë e këtij sporti. Që nga ndryshimi i rregullit tre vjet më parë, Biles u bë sportistja e parë që kalon 60 pikë në raundin e plotë. Gjatë ditës së parë të garës së përgjithshme, Biles shënoi 60,450 pikë, duke dominuar. Një situatë që u përsërit ditën e dyte, kur arriti 59.300 pikë, duke marrë një rezultat të përgjithshëm prej 119.750 dhe duke qenë më e mira në të gjitha specialitetet. Një sinjal i fortë i Biles në prag të Lojërat Olimpike "Paris 2024", se këtë herë askush nuk do ta ndalë për të marrë të artën, pas problemeve psikologjike që pati në Olimpiadën e fundit.

### Ronaldo komenton transferimin e Mbappes në Real Madrid

Kylian Mbappe është zyrtarizuar si futbollist i ri i Real Madridit. Ylli francez u transferua si agent i lirë, pasi nuk e ka vazhduar kontratën me PSG-në. Pas zyrtarizimit, ish-futbollisti i Realit, Cristiano Ronaldo, i ka bërë një koment interesant Kylian Mbappes. "Eshtë radha ime të shkoj! Mezi pres të shoh të ndezësh 'Bernabeu'! Hala Madrid!", ka komentuar Ronaldo.

### Chelsea nxjerr në shitje Sanchezin

Robert Sanchezi është duke kaluar ditët e tij të fundit si lojtar i Chelseat. Spanjollia iu bashkua klubit londinez verën e vitit të kaluar nga Brightonit, por paraqitjet e tij nuk kanë qenë në nivel të pritshëm. "Give Me Sport" raporton se blutet janë të gatshëm të ndahen me portierin 26-vjeçar spanjoll, vetëm një vit pas ardhjes së tij nga Brightonit. Dean Jones ka treguar se Chelsea po kërkon alternativa në portë, duke evidentuar pakënaqësinë e tij me paraqitjen e Sanchezit. Përkundër se paguan 28 milionë euro përfundimtarin e tij, Chelsea është gati ta largojë Sanchezin edhe nëse vjen ndonjë ofertë edhe më e ulët.

### Neymari në mbështetje të Vini Jr përfundimtarit

Vinicius Jr është një nga kandidatët kryesorë përfundimtarit. Braziliani shënoi 24 gola dhe dha 11 asistime në 39 paraqitje me Real Madrid këtë sezon. 23-vjeçari ishte një lojtar kyç përfundimtar "Los Blancos" këtë sezon pasi Madridi fitoi La Ligën dhe Ligën e Kampionëve. Neymari ka folur në mbështetje të bashkëkombësitsë të tij përfundimtarit. Duke thënë se ata kanë një marrëdhënie të shkëlqyer. "Unë dhe Vini kemi një marrëdhënie të mrekullueshme dhe ai është një djalë i mrekullueshëm", ka thënë Neymari. "Unë e dua Vinin. Ai është një mik i madh me të cilin më prezantoi futbollin. Patjetër që do të kérkoj që ai ta fitojë 'Topin e Artë'", ka deklaruar Neymari.

Raportet e Mourinhos me Guardiolan nuk janë më të mirat dhe këtë e tregojnë deklaratat e fundit të portugezit përfundoi me fitoren 2-0 të "Los Blancos". Mourinho ishte kritik përfundimtar e Guardiolanit.

kanë arrdhur në finalen e Ligës së Kampionëve mes Real Madridit dhe Borussia Dortmundit, e cila përfundoi me fitoren 2-0 të "Los Blancos". Mourinho ishte kritik përfundimtar e Guardiolanit.

qëndrimin e tij ndaj skuadrave të tjera të Premierë Ligës si Chelsea, Manchester United dhe Tottenham Hotspur. "Mendoj se në këtë moment Pep Guardiola po qesh me



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoniçarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 04.06.2024 bënë shpallje publike për dhënien e pronës së paluajtshme me qera.

## Shpallje Publike T-24-7

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK:  
Parku Industrial  
MITROVICË  
40000  
Personi Kontaktues:  
Behxhet Nimani  
E-mail:  
behxhetnimani@hotmail.com  
Telefoni:  
+381 28 538 050  
Faks:  
+381 28 539 202

### Shpallja Publike

#### Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave të objekteve në Njësinë Biznisore Fabrika e Akumulatorëve dhe Njësinë Biznisore Industria Kimike
- Sipërsfaqja dhe çmimi filletar

#### 1. Njësia Biznisore Fabrika e Akumulatorëve

Njësia Biznisore Fabrika e Akumulatorëve												
Nr	Emri i Objektit	Siperfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i Qerasë (€)	Siperfaqja e pambuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Depoja 1 e rjetave	240.00	1.00	0.18	1.18	283.20	0.00	0.00	0.00	0.00	283.20	
2	Depoja 2 e rjetave	90.00	1.00	0.18	1.18	106.20	0.00	0.00	0.00	0.00	106.20	
3	Parcela para depos së Akumulatorëve	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,500.00	0.34	0.06	0.40	600.03	600.03

#### 2. Njësia Biznisore Industria Kimike

Njësia Biznisore Industria Kimike												
Nr	Emri i Objektit	Siperfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i Qerasë (€)	Siperfaqja e pambuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Parcela 4 A	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,000.00	0.50	0.09	0.59	590.00	590.00
2	Parcela 10 A	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,000.00	0.50	0.09	0.59	590.00	590.00
3	Objekti-Halla e lëndës së parë-Fosfat	5,400.00	0.85	0.153	1.003	5,416.20	0.00	0.00	0.00	0.00	5,416.20	

Kriteret e Dhënes:

Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë

Data e shpalljes:

04.06.2024

Sqarimi:

deri me 20.06.2024

Kërkesa për pjesëmarrje:

Data(t) përkatesë deri: 20.06.2024

Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave:

Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te myllur) (Origjinali dhe Kopja)

Afat i fundit i dorëzimit:

20.06.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit:

Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.

Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njostimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

#### Shënime shpesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin përmes përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

#### Aneksi 1

#### OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e vlerës së qerasë	
a	Siperfaqa e mbuluar m <sup>2</sup>
b	Çmimi për metër katrorë (€)
c = b*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)

D=a*c	Vlera e qerasë për siperfaqen e mbuluar (€)
e	Siperfaqa e pa mbuluar m <sup>2</sup>
f	Çmimi për metër katrorë (€)
g = f*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)
H=e*g	Vlera e qerasë për siperfaqen e pa mbuluar (€)
I=D+H	Gjithsejt qeraja (€)

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bje në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkuari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhëne me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshëmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimive, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përban informata përbajtësish të gabueshme ose mashtrueze.

#### Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Sera Produkt” SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811976622 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Sera Produkt" D.O.O. Vushtri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811976622 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Sera Produkt” L.L.C. with headquarters Vushttri, has come to the decision to quit its business: 811976622 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “UHB B Creative” SH.P.K. me pronar Valbone Haffke dhe Buen Bajrami, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812071710 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "UHB B Creative" D.O.O. sa vllasnikom Valbone Haffke dhe Buen Bajrami, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812071710 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljuvania o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “UHB B Creative” L.L.C. with owner Valbone Haffke dhe Buen Bajrami, has come to the decision to quit its business: 812071710 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**RESTAURANT**

---



**SWISS**

---

**TAVERNA**

---

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Baraka" SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810817950.
  - Arben Uka shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".
  - Donjeta Mani shpall të pavlershme dëftesën e klasës se 10 te shkollës se mesme "Dr. Xheladin Deda".
  - Luljeta Kuçi shpall të pavlershme dëftesat e klasës III dhe IV dhe diplomën e shkollës se mesme "Dr. Xheladin Deda".
  - Bleona Hasani shpall të pavlershme 3 dëftesat dhe certifikatën e testit te maturës shkolla e mesme "Xheladin Deda".
  - Behije Istrefi shpall të pavlershme dëftesën e shkollës fillore "Mehe Uka".
  - Qamil Dulauka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Teknike "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë, drejtimi Kimi Teknologji.
  - Agnese Basha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Leke Dukagjini" Prizren.
  - Mentor Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- IX shfmu " Xhevati Berisha " Prizren.
  - Isak Kelmendi shpall te pavlefshme diplomën W.K "11 Marsi" Prizren.
  - Artor Sylmetaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Bajram Curi " Romaje.
  - Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjelëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
  - Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
  - Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
  - Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA  
1992





**ROYAL CROWN**  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
0.5L